



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 143/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Goran Milenković – Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Blerim Dina-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NSHT”Viktory Com”&”Comany Murseli” dhe “Grand Construction” SH.P.K.-, kundër njoftimit për dhënie të kontratës pre LOT 1 ku i rekomanduar për dhënie të kontratës për Lot 1 është OE “ NTSH Drini Company & Berisha Com” për aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Mirëmbajtja e Auto rrugëve pjesa I-rë: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr. prokurimit: 632-18-6642-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë ,më datën 25.04.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuara ankesa e operatorit ekonomik NSHT”Viktory Com”&”Comany Murseli” dhe “Grand Construction” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e Auto rrugëve pjesa I-rë: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr. prokurimit: 632-18-6642-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës dhe anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit me titull “Mirëmbajtja e Auto rrugëve pjesa I-rë: me nr. prokurimit: 632-18-6642-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, dhe se nëse edhe me tutje AK ka interes për këtë aktivitet të prokurimit të njëjtin mund ta Ritenderoi konform dispozitave të LPP-së(për Lot 1).

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“NSHT”Viktory Com”&”Comany Murseli” dhe “Grand Construction” SH.P.K.,aprovohet pjesërisht si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë: 14.09.2018

Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë publike kornizë/vlerë e madhe

Vlera e parashikuar e kontratës :430,000.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52):tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave:

Data e hapjes së ofertave.:08.10.2018

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave: 19.10.2018

Data e njoftimit me letrën standarde : 19.03.2018

Data e njoftimit për dhënien e kontratës (vendimi i AK): 19.03.2018

Data e kërkesës për rishqyrtim 22.03.2018

Data e vendimit nga AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim26.03.2019

Operatori ekonomik ankues Viktory Com&Company Murseli&Grand Construction",si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me04.04.2019me nr. 143/19,kundër njoftimit për dhënie te kontratës LOT 1, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Mirëmbajtja e Auto rrugëve pjesa I-rë: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr. prokurimit: 632-18-6642-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, duke pretenduar ne shkelje te këtyre dispozitave te LPP-së:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin7, 56,59,61,69 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.04.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesnë raportin e dt:19.04.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin ankimorë për korrigjimin e çmimit të OE ankues nga ana e AK-së, me rastin ofertimit OE ankues për tri pozicionet ka vendosur vlerën e TVSH-së prej 0.18€.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 07.03.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Lot I-rë: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane

Nr. i art.	Përshkrimi	Sasia km'	Çmimi për njësi	TVSH €	Çmimi për njësi
	ÇMIMI TOTAL	Përqindja e pikave për vlerësim (ne %)		ÇMIMI TOTAL € (pas vlerësimit në përqindje)	

	Pa TVSH €	ME TVSH €	ME TVSH €	
1	Pastrimi nga bora dhe akulli 600	10.00	0.18	10.18
6,108.00	20 % (e pikëve ne vlerësim)	1,221.60		
2	Pastrimi nga bora dhe akulli plus hedhje të kripës 1000	145.00	0.18	
145.18	145,180.00 60 % (e pikëve ne vlerësim)	87,108.00		
3	Vetëm hedhje të kripës 600	50.00	0.18	50.18
30,108.00	20 % (e pikëve ne vlerësim)	6,021.60		

Totali i përgjithshëm: 100%

Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do te vlerësohen ne baze te kësaj vlere). Kjo është vlere e cila do te duhet te shënohet ne Formularin e ofertës dhe do te lexohet gjate hapjes publike. 94,351.20

Në këtë rast AK ka bërë korrigjimin e vlerës së TVSH-së, duke caktuar vlerën e TVSH-së prej 18% për secilin pozicion, dhe pas këtij korrigjimi ka nxjerrur çmimin e OE prej 111.156€.

Ky kalkulim i AK-së është i sakt nëse merret për bazë vlere e TVSH-së prej 18%, mirëpo nuk qëndron arsyetimi i AK-së për eliminim të OE mbi bazën se ndryshimi në çmim është më i madh se 2%, sepse sipas përgjigjes së KRPP-së ndryshimi i vlerës së TVSH-së nuk përkufizohet si gabim aritmetik.

Tek pyetjet e shpeshta në KRPP-së lidhur me llogaritjen e gabueshme të vlerës së TVSH-së, përgjigja nr.46 shënon si në vijim:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Me gjithë faktin se çmimi i OE ankues pas korrigjimit të TVSH-së ndryshon, duhet cekur se edhe pas korrigjimit çmimi i OE nuk e tejkalon vlerën e parashikuar nga AK për Lot.1.

Vlera e parashikuar prej AK-KK Gjakovë për lot.1 është 170,000€, ndërsa çmimi i OE ankues me korrigjimin e bërë prej AK është 111,156€.

Do të thotë se edhe pas korrigjimit, çmimi i OE ankues është dukshëm më i ulët se vlera e parashikuar nga AK, dhe po ashtu nuk qëndron pretendimi i AK se OE ka tejkaluar mbi 2% të vlerës me gabim aritmetikorë, pasi siç e cekëm më lart TVSH nuk mund të llogaritet si gabim aritmetikor.

Në rastin konkret AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së kur ka eliminuar OE ankues duke konstatuar se OE ankues ka tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e AK për pajisjet e kërkuara dhe stafin. Sipas shkresave të ofruara nga AK pas rivlerësimit, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar gjithsej 11 libreza të qarkullimit për kamion. Kërkesë e AK-së ka qenë që 6 kamion të jenë për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës, ndërsa OE sipas shkresave të lëndës ka ofruar dokumentet unike doganore për pllugj/pastrues të borës dhe për shpërndarës të kripës sipas kërkesës së AK.

OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka ofruar kontrata për shitblerje të ekskavatorëve sipas kërkesës së AK-së.

OE i rekomanduar për kontratë lidhur me stafin fillimisht ka pas 7 kontrata. Pas kthimit të lëndës në rivlerësim dhe sipas vendimit të OSHP për sqarime shtesë, AK ka kërkuar sqarime nga OE ku i njëjti ka ofruar sqarime dhe ka plotësuar kërkesën e AK. Andaj vlerësoj se ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Pajisje për të cilat nuk mund të gjinden dëshmi adekuate, lidhen me kërkesën e AK-së “Pastrues i borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës, i vogël (mini)”.

OE si në listën e prezantuar të pajisjeve, ashtu edhe në dokumentet unike doganore për këtë kërkesë ka paraqitur disa pajisje të emëruara “shpërndarës të kripës”.

Gjatë fazës së rivlerësimit AK ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, ku i njëjti ka ofruar foto dhe duda doganor për tri pajisje në emër të Drini Company ku njëra sipas dudit doganor është “Makinë për larjen e rrugëve me furqa”, ndërsa dy tjera “Makinë për pastrimin e rrugëve me furqa”.

Duhet të theksojmë se këto pajisje nuk kanë qenë të prezantuara në listën e pajisjeve të Drini Company dhe po ashtu nga përshkrimi në dud doganor shihet se të paktën njëra është për “larjen” e rrugëve me furqa.

Do të thotë OE nuk ka ofruar sqarime për pajisje ekzistuese sipas listës së pajisjeve në ofertë të vetë, por ka ofruar dëshmi për pajisje shtesë që nuk gjenden në ofertën origjinale.

Ndërsa shpërndarësit e kripës në ofertë origjinale në listë të pajisjeve janë paraqitur vetëm 2, njëri STA/HD ID 90 viti prodhimit 1993, dhe tjetri STA/HD nr.serik.12144 viti prodhimit 1990, të cilët sipas dëshmive të ofruara – fotografive dhe dudave doganor duken të jenë shpërndarës të kripës të mëdhenj të vendosur në kamion të mëdhënjë,

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar aneksin 6, ky aneks ka të bëjë me listën e kontratave të realizuara të OE, dhe kjo listë është plotësuar nga OE sipas kërkesës së AK-së. Andaj vlerësoj se ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

OE ankues ne ankesën e tij pretendon se AK pa drejtësisht e ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, dhe kjo qëndron sa i përket arsyeve të eliminimit të cilat janë përsëritur nga vlerësimet e më parshme.

Me gjithë atë me rastin e këtij rivlerësimi AK si arsye të eliminimit ka potencuar edhe mungesën e deklaratës nën betim për pranueshmëri të OE sipas nenit 65 të LPP-së për anëtarin e e konozrciumit Murseli.

Me gjithë se ky nuk ka qenë arsyetim për eliminim në vlerësimet e mëparshme, pas qasjes në ofertat e OE ankues në platformën e E Prokurimi, nuk kam mundur të gjejë deklaratën në betim për OE Murseli.

Kjo deklaratë duhet të plotësohet nga të gjithë OE-të pjesëmarrës, dhe me që në ofertën e OE ankues nuk gjendet deklarata në emër të OE Murseli, arsyetimi i AK-së për eliminim të OE në këtë pikë është i bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet ankimore), ndërsa rekomandon që njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.04.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.04.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.04.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi OE ankues z. Qerimi deklaroj: Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe kjo lende është kthyer 3 here në rivlerësim dhe asnjë here nuk është respektuar vendimi i OSHP-se nga AK KK-Gjakove, pra AK ka bërë shkelje të nenit 7, 56, 59, 61, RrUOPP-në Operatori i cilësuar si i suksesshëm nuk e plotëson kriterin për Lot 2 e lere me për Lot 1. Ku AK ka kërkuar mbi 16 makineri ndërsa OE ka paraqit vetëm 7 nga to njëjta e ka konstatuar edhe eksperti ku ai ka paraqitur disa kompresor në vend të plugjeve për largimin e bores, pra nëse bie bore në fshatra dhe poashtu në qytet ai nuk mund të bëjë punën në të njëjtën kohë në të dy Lotot. Gjithashtu është joabnormalisht i ulët ku vlera e kontratës ka qenë 430.000. euro ndërsa OE ka paraqit çmim 17.000 euro.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe të kthehet lënda në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, konstatimeve analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe shoshitjes së provave në tërësi në shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin ankimorë për korrigjimin e çmimit të OE ankues nga ana e AK-së, me rastin ofertimit OE ankues për tri pozicionet ka vendosur vlerën e TVSH-së prej 0.18%. Në këtë rast AK ka bërë korrigjimin e vlerës së TVSH-së, duke caktuar vlerën e TVSH-së prej 18% për secilin pozicion, dhe pas këtij korrigjimi ka nxjerrë çmimin e OE prej 111.156€ Ky kalkulim i AK-së është i sakt nëse merret për bazë vlera e TVSH-së prej 18%, mirëpo nuk qëndron arsyetimi i AK-së për eliminim të OE mbi bazën se ndryshimi në çmim është më i madh se 2%, sepse sipas përgjigjes së KRPP-së ndryshimi i vlerës së TVSH-së nuk përkufizohet si gabim aritmetik.

Tek pyetjet e shpeshta në KRPP-së lidhur me llogaritjen e gabueshme të vlerës së TVSH-së, përgjigja nr.46 shënon si në vijim: 46. *Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ne.*

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Paneli shqyrtues konstaton se me gjithë faktin se çmimi i OE ankues pas korrigjimit të TVSH-së ndryshon, duhet cekur se edhe pas korrigjimit çmimi i OE-së nuk e tejkalon vlerën e parashikuar nga AK për Lot.1. Vlera e parashikuar prej AK-KK Gjakovë për lot.1 është 170,000€, ndërsa çmimi i OE ankues me korrigjimin e bërë prej AK është 111,156€.

Andaj nga sqarimet e dhëna si me lart paneli shqyrtues konstaton se edhe pas korrigjimit, çmimi i OE ankues është dukshëm më i ulët se vlera e parashikuar nga AK, dhe po ashtu nuk qëndron pretendimi i AK se OE ka tejkaluar mbi 2% të vlerës me gabim aritmetikorë, pasi siç e cekëm më lart TVSH nuk mund të llogaritet si gabim aritmetikor.

Lidhur me pretendimin ankimorë të ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e AK për pajisjet e kërkuara dhe stafin. Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues konstaton se sipas shkresave të ofruara nga AK pas rivlerësimit, shihet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar gjithsej 11 libreza të qarkullimit për kamion. Kërkesë e AK-së ka qenë që 6 kamion të jenë për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës, ndërsa OE sipas shkresave të lëndës ka ofruar dokumentet unike doganore për pllugj/pastrues të borës dhe për shpërndarës të kripës sipas kërkesës së AK. OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka ofruar kontrata për shitblerje të ekskavatorëve sipas kërkesës së AK-së.

Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë lidhur me stafin fillimisht ka pas 7 kontrata. Pas kthimit të lëndës në rivlerësim dhe sipas vendimit të OSHP për sqarime shtesë, AK ka kërkuar sqarime nga OE ku i njëjti ka ofruar sqarime dhe ka plotësuar kërkesën e AK. Andaj vlerësojmë se ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues konstaton se pajisje për të cilat nuk mund të gjinden dëshmi adekuate, lidhen me kërkesën e AK-së “Pastrues i borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës, i vogël (mini)”. OE si në listën e prezantuar të pajisjeve, ashtu edhe në dokumentet unike doganore për këtë kërkesë ka paraqitur pajisje të emëruara “shpërndarës të kripës”. Gjatë fazës së rivlerësimit AK ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, ku i njëjti ka ofruar foto dhe duda doganor për tri pajisje në emër të Drini Company ku njëra sipas dudit doganor është “Makinë për larjen e rrugëve me furqa”, ndërsa dy tjera “Makinë për pastrimin e rrugëve me furqa”. Paneli shqyrtues

konstaton se këto pajisje nuk kanë qenë të prezantuara në listën e pajisjeve të OE:Drini Company dhe po ashtu nga përshkrimi në dud doganor shihet se të paktën njëra është për “larjen” e rrugëve me furqa.

Do të thotë OE nuk ka ofruar sqarime për pajisje ekzistuese sipas listës së pajisjeve në ofertë të vetë, por ka ofruar dëshmi për pajisje shtesë që nuk gjenden në ofertën origjinale, e që një veprim i këtillë bie ndesh me nenin 7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se shpërndarësit e kripës në ofertë origjinale të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës në listë të pajisjeve janë paraqitur vetëm 2, njëri STA/HD ID 90 viti prodhimit 1993, dhe tjetri STA/HD nr.serik.12144 viti prodhimit 1990, të cilët sipas dëshmive të ofruara – fotografive dhe dudave doganor duken të jenë shpërndarës të kripës të mëdhenj të vendosur në kamion të mëdhenjtë, çka edhe kjo është në kundërshtim me kërkesat e AK-së, sepse OE ka ofruar të dhëna vetëm për dy pajisje e jo për tri siç është kërkuar nga AK. Për më tepër as këto dy pajisje nuk janë konform kërkesave të AK-së.

Andaj paneli shqyrtues konstaton se në këtë pikë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën e AK-së, me ç’rast AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke e rekomanduar për dhinë të kontratës këtë OE edhe pse i njëjti OE është i pa përgjegjshëm sipas sqarimeve të dhëna si më lart.

Lidhur me pretendimin ankimorë të ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar aneksin 6, paneli shqyrtues konstaton se ky aneks ka të bëjë me listën e kontratave të realizuara të OE, dhe kjo listë është plotësuar nga OE sipas kërkesës së AK-së. Andaj vlerësojmë se ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Paneli shqyrtues konstaton se qëndron arsyeja e eliminimit të OE ankues e dhëne me rastin e rivlerësimi ku AK si arsye të eliminimit ka potencuar mungesën e deklaratës nën betim për pranueshmëri të OE sipas nenit 65 të LPP-së për anëtarin e konozrciumit “Murseli”. Është e qëndrueshme kjo arsye për eliminim për faktin se eksperti shqyrtues, pas qasjes në ofertat e OE ankues në platformën e E Prokurimi, nuk ka mundur të gjejë deklaratën në betim për OE Murseli, e që kjo deklaratë duhet të plotësohet nga të gjithë OE-të pjesëmarrës, prandaj duke pas parasysh faktin se në ofertën e OE ankues nuk gjendet deklarata në emër të OE “Murseli”, arsyetimi i AK-së për eliminim të këtij operatori ekonomik në këtë pikë është i bazuar.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se asnjëri nga operatorët ekonomik as ai fitues dhe as ai i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk kanë plotësuar kërkesat e AK-së ashtu siç u sqarua edhe më lart, dhe se sipas raportit të vlerësimit nuk ka ofertues tjerë të përgjegjshëm, konstaton se AK aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e autorrugëve pjesa I –re” ta anuloj në pajtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin

44.7 pika ii të RRUOPP, në të cilin thuhet: Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: (ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi | Panelit Shqyrtues



Z. Goran MILENKOVIĆ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesë padi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komuna Gjakovë

1x1 OE- NSHT"Viktory Com"&"Comany Murseli" dhe "Grand Construction" SH.P.K.-,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.